



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 81

Tiranë – E martë, 18 prill 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 16, datë 12.4.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr.37, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsim”, thirrja e dytë, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016”.....	4893
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 17, datë 12.4.2017	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2017, të grantit “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II.....	4894
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 18, datë 12.4.2017	Për shpalljen e thirrjes II për vitin 2017, për financimin e projekteve nga granti “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II.....	4896
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 19, datë 12.4.2017	Për shpërndarjen e financimit për fond për përgatitje projektsh (projektim), thirrja I për vitin 2017, të grantit “Infrastruktura Vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I.....	4901
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 20, datë 12.4.2017	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, të grantit “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I.....	4903





Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e financimit të projektit, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën e financimit të alokuar për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në vitin 2016 dhe 2017.
3. "Vlera e financimit për vitin 2017" është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor "Arsimi bazë" dhe "Arsimi i mesëm i përgjithshëm" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për vitin 2017.
4. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite.

VENDIM

Nr. 17, datë 12.4.2017

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I, PËR VITIN 2017, TË GRANTIT "SHQIPËRIA DIXHITALE", PROGRAMI "SHQIPËRIA DIXHITALE", SHTYLLA II

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130 datë 15.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2017, për grantin "Shqipëria dixhitale", programi "Shqipëria dixhitale", shtylla II, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2017, nga programi buxhetor "Infrastruktura vendore dhe rajonale", pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në "Fletoren zyrtare", duhet të paraqesin në sekretariatun teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik të projektit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit, përpara fundit të tremujorit të dytë të vitit 2017, si dhe të dërgojnë informacion periodik mujor mbi ecurinë e projekteve, pranë sekretariatit teknik të

ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtë të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi dhe të informojë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave, ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI

Niko Peleshi

Zëvendëskryeminstri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1 Lista e projekteve të reja, thirrja e I, për vitin 2017, për grantin “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, me cikël zbatimi 2017-2018.

N r	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit në FZHR (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
1	Bashkia Elbasan	Ndërtimi i infrastrukturës së telekomunikacionit për bashkinë Elbasan (fibër optike dhe Wi-Fi)	95,822,963	79,989,629	55,992,740
2	Bashkia Vlorë	Sistemi Multifunksional “Smart City” LUNGOMARE	70,560,000	64,247,040	64,247,040
3	Bashkia Malësi e Madhe	Sistemi Wi-Fi për qytetin, shkollat dhe qendra të populluara të njësive administrative	14,932,850	14,734,850	14,734,850
4	Bashkia Gjirokastrë	Ndërtimi i një modeli 3D i qytetit të Gjirokastrës-Virtual City	13,040,000	9,200,000	9,200,000
5	Bashkia Tiranë	Sistemi i qendëruar për monitorimin e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimin e kontrollit	54,600,000	45,000,000	27,000,000
TOTALI			248,955,813	213,171,519	171,174,630

Shënim:

1. “Vlera e financimit në FZHR” përfaqëson kontributin financiar të FZHR-së në “vlerën e plotë të projektit”. Diferenca midis vlerës së plotë të projektit dhe vlerës së financimit nga FZHR-ja, është bashkëfinancim i projektit nga autoriteti kontraktues.

2. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën e zbatimit dhe mirëmbajtjes së projektit. Mirëmbajtja bashkëfinancohet nga vetë njësiti e qeverisjes vendore.

3. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja të programit buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale” të Ministrisë së Zhvillimit Urban, për vitin 2017.

4. Likuidimi financiar për vlerën e kërkuar për financim (ose për vlerën e zbatimit pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Zhvillimit Urban, në bashkëpunim me ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet me shtrirje në 2 vite. Vlera e kursyer nga lidhja e kontratës i zbritet financimit të vitit 2018. Sipas ecurisë së punimeve mund të avancohet financimi më shumë në vitin 2017, nga vlerat e kursyera të kontratave të grantit “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”.

5. Projekti nr.5 i listës së mësipërme, duhet që para zhvillimit të procedurës së prokurimit, të marrë konfirmimin për termat e referencës së projektit nga AKSHI dhe ASIG. Ky projekt të shërbejë si model i unifikuar dhe standardizuar për t’u zbatuar edhe nga bashkitë e tjera të vendit.

**VENDIM****Nr. 18, datë 12.4.2017**

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES II PËR
VITIN 2017, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTEVE NGA GRANTI
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, PROGRAMI
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, SHTYLLA II**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes II për vitin 2017, për financimin e projekteve të reja nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II.

1.2 Drejtimit e thirrjes së dytë për financim janë:

a) modernizimi i qyteteve dhe bashkive, përmes sistemeve të informacionit dhe shërbimeve për qytetarët;

b) ndërtimi i platformave informatike të qëndëruara dhe unifikuara, në funksion të pushtetit vendor.

2. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në gerrat “a” dhe “b” të pikës 1.2 të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore e partneritetet rajonale, dhe/ose Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, sipas marrëveshjes së partneritetit, në rastin e partneriteteve rajonale dhe ndërvendore, si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për projekte me shumë përfitues, kur ka marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Për drejtimit sipas shkronjës “a”, të pikës 1.2 të këtij vendimi, vlera e financimit të thirrjes II për vitin 2017, të shpërndahet sipas kushteve financiare, si më poshtë vijon:

a) Për njësitë e qeverisjes vendore, me popullsi deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera e financimit të jetë jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për projekt.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera e financimit të jetë jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për projekt.

c) Për Bashkinë e Tiranës dhe agjencitë e zhvillimit rajonal, sipas marrëveshjes së partneritetit, vlera e financimit të jetë jo më shumë se 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekë për projekt.

ç) Financimi mbulon koston e zbatimit të projektit, ndërsa mirëmbajtja të kryhet nga vetë aplikuesi, në formë bashkëfinancimi në projekt.

4. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara kryhet nga sekretariati teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas kritereve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në “Fletoren zyrtare”	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së grantit, programit dhe shtyllës së financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
14 ditë kalendarike nga botimi në Fletoren zyrtare	Aplikuesit sipas pikës 2, të këtij vendimi.	Dërgimi i projekteve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: - Aplikimi online në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi <i>online</i> për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203. - Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet në sekretariatit teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (në Kryeministri), <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por ato dorëzohen vetëm në sekretariatit teknik pranë Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.</u> - Për çdo informacion të nevojshëm në lidhje me aplikimin <i>online</i> mund të kontaktoni: - AKSHI; email: support_FZHR@akshi.gov.al (shërbimi për aplikimin online e-albania); - Sekretariati Teknik, pranë Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike email: sekretariati@inovacioni.gov.al
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas shtojcës III, të këtij vendimi.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim, si dhe projekt-vendimin që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
3 ditë pune nga dërgimi i propozimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik, koordinon dhe organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.



Shtojcë II: FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë Sekretariatit Teknik.
Personi përgjegjes (*) Kontaktet: Tel,Mob,email,adresë	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”).
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është programi ku bën pjesë projekti (“Shqipëria dixhitale”).
Nënsektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënsektori i projektit (komponentët e programit të investimit në TIK).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe i zbatimit të projektit.
Data e mbarimit të projektit (*)	
Shtirja hapësinore e projektit ☐ Lokal ☐ Ndërvendor ☐ Rajonal ☐ Ndër-rajonal ☐ Kombëtar	Në rastet kur aplikuesi është bashki, shtirja e projektit mund të jetë lokale ose ndërvendore, kur projekti aplikohet në më shumë se një bashki. Për aplikimet ndërvendore mes dy apo më shumë bashkive, duhet të bashkëngjitet në aplikim edhe marrëveshja e partneritetit lidhur midis tyre. Në rastet kur aplikuesi është agjenci zhvillimi/AKSHI, shtirja e projektit mund të jetë rajonale ose ndër-rajonale. Për aplikimet rajonale dhe ndër-rajonale, agjencitë aplikuese duhet të bashkëngjisin në aplikim edhe marrëveshjen e partneritetit lidhur midis tyre dhe/ose 2 apo më shumë bashkive.
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Përshkrimi i gjendjes aktuale; - Objektivat funksionale dhe qëllimi strategjik; - Zgjidhja teknologjike; - Grupet e interesit; - Logjistika dhe koha (vlerësimi i koston, burimet etj.); - Komunikimi me sistemet e tjera lokale ose qeveritare; - Risku i realizimit të projektit.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë dhe grupet e interesit që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike kosto që aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Specifikoni sa parashikohet të jenë këto kosto, si do të sigurohen etj. - Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes dhe të garantohet nga aplikuesi mbulimi i tyre.



Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë e qeverisjes qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kosto që kërkohej është e njëjtë me koston totale të projektit (në çdo rast vlera të jetë me TVSH).
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore (*)	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore apo nga donatorë.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera në monedhën Lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën Lekë.
Kosto totale e projektit (*)	Kosto totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në modernizimin e qeverisjes apo të shërbimeve (Opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve.	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve, të aksesit në shërbime, rritjen e mbulimit etj.
Deklarime (*)	Aplikanti deklaron se: - Projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve. - Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioriteteve. - Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar për pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. - Janë zbatuar rregullat e llogaritjes së fondit dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e koston (përfshirë mirëmbajtjen) dhe vlerës financiare të projektit, nëse kjo është e aplikueshme.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikantit përmban: - projektin teknik (ToR sipas modelit të AKSHI); - preventivin; - argumentimin teknik; - përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit; - studimin e tregut.

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Nuk do të pranohen aplikimet të cilat nuk janë të shoqëruar me studimin e tregut.

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

a) aplikimi *online* në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi *online* për FZHR (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

ose

b) me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, në sekretariat teknik pranë Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2. Format i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrueshmësi i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.

**Shtojca III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM (Shtylla II, Programi Shqipëria Dixhitale, granti “Shqipëria dixhitale”)**

Këto kriteret përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë**, i një projekti që propozohet për financim/miratim nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

Kriteret/kërkesat e domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt, i përcakton sekretariati teknik.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e ndikimit në arritjen e objektivave të politikës dhe ndikimi në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
2. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara, si dhe efektshmëria dhe dobishmëria e përdorimit të fondeve për financimin e tij, nga njësitë e qeverisjes vendore apo agjencitë e zhvillimit/AKSHI: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.
3. Ndikimi i projekteve në modernizimin e qyteteve dhe bashkive, përmes sistemeve të informacionit dhe të të dhënave në shërbim të qytetarëve dhe qytetit, si dhe të zhvillimit rajonal dhe lokal, ofrimin e shërbimeve të reja, përmirësimin e efikasitetit të punës dhe administrimit të bashkive të reja, rritjen e cilësisë së jetës në bashkitë e vendit, shtrirjen gjeografike të shërbimeve dhe rritjen e aksesit në to, përmes mbulimit në zonat e pambuluara ose në nevojë për përmirësim, avantazhet për përdoruesit, qytetarët dhe biznesin: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.
4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve /përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
6. Niveli i bashkëfinansimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

**VENDIM****Nr.19, datë 12.4.2017**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR FOND PËR PËRGATITJE
PROJEKTESH (PROJEKTIM), THIRRJA I
PËR VITIN 2017, TË GRANTIT
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE
RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
TË INFRASTRUKTURËS VENDORE
DHE RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130 datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për fond për përgatitje projektesh (projektim), thirrja I për vitin 2017, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2017, nga programi buxhetor “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, propozimet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në “Fletoren zyrtare”, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik, si edhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese, sipas tabelës nr.1, të këtij vendimi, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, dokumentacionin ku të jenë specifikuar lista e projekteve që do të hartohen dhe detyra e projektimit për secilin projekt, të dyja këto të jenë miratuar në bordin përkatës, si edhe marrëveshjen e bashkëpunimit me bashkitë në territorin e të cilave shtrihet projekti dhe/ose me partnerë të tjerë bashkëfinansues të

mundshëm për zbatimin e projektit, përpara fillimit të procedurës së prokurimit.

4. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e kontratës, në fillim të tremujorit të tretë, të vitit 2017. Për fondet e propozimeve për përgatitje projektesh të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtë të rishqyrtojë financimin dhe t’i rishpërndajë ato, për një projekt tjetër.

5. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

6. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Urban, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1 Lista e propozimeve për përgatitje projektsh të reja, thirrja II për vitin 2017, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me cikël zbatimi 2017.

Nr.	Emërtimi	Vlera e fondit për përgatitje projektsh (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
AZHR-1			
1	Zhvillimi i ballinave ujore: “Porti turistik i Liqenit të Shkodrës dhe limanet përgjate vijës liqenore”, Buna Marina në Pulaj - Velipojë	6,576,000	6,576,000
2	Projektim i rrugës panoramike në bregun lindor të liqenit Shkodër, me qëllim promovimin e itinerareve këmbësore dhe çiklistike, si dhe ndërthurja e rrugës respektive me itineraret ndërkombëtare ekzistuese	15,654,435	15,654,435
3	Përmirësimi i infrastrukturës ndërlidhëse ndërmjet qarkut Shkodër dhe qarkut Lezhë, nëpërmjet rikonstruksionit të aksit rrugor “Ura Gjo Lulit – Torovicë – Balldren”	15,360,640	15,360,640
4	Tregu Rajonal Milot, (Bashkia Kurbin)	3,852,000	3,852,000
5	Projekt ide përfundimtare për krijimin e terminaleve inter-modale në qendrat urbane kryesore lidhëse, si dhe stacionet e tjera mbështetëse në zonën e zhvillimit rajonal 1	5,193,255	5,193,255
6	Projektim i terminalit të Autobusëve “Bashkia Kukës”	3,363,670	3,363,670
TOTALI		50,000,000	50,000,000
AZHR-2			
7	Krijimi i akseseve të reja dhe përmirësimit të lëvizshmërisë ndërmjet zonave për një kohezion dhe ndërveprim ndërvendor dhe ndërajonal	28,000,000	28,000,000
8	Ndërtimi i shëtitores për këmbësorë dhe biçikleta përgjatë vijës bregdetare nga Komanda e Forcave Detare (Bashkia Durrës), deri tek përroi Leshniqe (Qeret, Bashkia Kavajë)	5,000,000	5,000,000
9	Rikualifikimi i qendrës urbane të termave, të aksit rrugor që e lidh me qendrën e qytetit si dhe shndërrimin e zonës pyjore pranë termave në tre parqe të arregduar të zonës së Bellovës, Dibër dhe Bilaj, Fushë Krujë	8,000,000	8,000,000
10	Rivitalizimi i parkut rajonal të Bedenit si katalizator i zhvillimit rajonal si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit përreth tij	2,000,000	2,000,000
11	Ripërtëritje e tregut rajonal – Rigjenerim të tregjeve në Maqellarë-Shupenzë-Klos dhe tregu Rrogozhinë me qëllim ripërtëritjen e traditave të promovimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore, blegtorale, artizanale dhe produkteve të tyre, në rajon	7,000,000	7,000,000
TOTALI		50,000,000	50,000,000
AZHR-3			
12	Hartim projekti për rivitalizimin e hapësirave publike dhe infrastrukturës në fshatrat e Rajonit 3	40,000,000	40,000,000
13	Hartim projekti për ngritjen dhe funksionimin e tregut të markës në qytetin e Elbasanit	2,470,000	2,470,000
14	Hartim projekti për ngritjen dhe funksionimin e terminalit të autobusave në qytetin e Elbasanit	1,410,000	1,410,000



15	Hartim projekti për përcaktimin e pikave panoramike të rajonit 3	1,410,000	1,410,000
16	Hartim projekti për shtigjet e këmbësorëve dhe biçikletave që lidhin qytetin e Beratit me kodrat përreth kalasë së Goricës	1,810,000	1,810,000
17	Hartim projekti për kanionet e Osumit	2,900,000	2,900,000
TOTALI		50,000,000	50,000,000
AZHR-4			
18	Përmirësimi i infrastrukturës rajonale: “Unaza e Drinos; Krijimi i aksit rrugor kthesa e Libohovës-Suhë-Stegopul-Saraqinishtë”, me një gjatësi rreth 12 km	15,000,000	15,000,000
19	Projektim i rrugës “Finic-Blerimas”, lidhëse e dy superstradave të reja që po ndërtohen Qafë Botë-Sarandë dhe Sarandë-Kardhiq me një gjatësi rreth 2.8 km, me qëllim promovimin e zhvillimit rajonal turistik, ekonomik e social	5,000,000	5,000,000
20	Projektim i qendrave të fshatrave tradicionale, bregdetare e malore duke përfshirë zonën përgjatë lumit të Vlorës dhe anës detit Jon, me qëllim rivitalizimin e fasadave të banesave tradicionale, kthimin e qendrave në hapësira publike, pedonale me gjelbërim	18,000,000	18,000,000
21	Projektim për përmirësimin e infrastrukturave ndërlidhëse, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë në disa nga monumentet e kulturës së kategorisë së parë të qarkut Vlorë, në funksion të turizmit kulturor dhe natyror.	7,500,000	7,500,000
22	Projektim për përmirësimin e shërbimit ndërlokal me autobusë mes Vlorës, Himarës dhe Sarandës për promovimin e turizmit bregdetar dhe kulturor rajonal	4,500,000	4,500,000
TOTALI		50,000,000	50,000,000

Shënim:

1. “Vlera e fondit për përgatitje projektsh” përfaqëson vlerën e financimit për përgatitje projektsh, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja të programit buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale” të Ministrisë së Zhvillimit Urban, për vitin 2017.
3. Nëse do të kryhen ndryshime në listën e projekteve të mësipërme, nga autoritetet kontraktuese, atëherë ajo duhet të jetë e miratuar nga bordet përkatëse të tyre, si edhe të paraqitet zyrtarisht pranë sekretariatit të Ministrisë së Zhvillimit Urban.

VENDIM

Nr. 20, datë 12.4.2017

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I
PËR VITIN 2017, TË GRANTIT
“REHABILITIM MJEDISOR,
GJELBËRIM DHE PYLLËZIM”,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr.130 datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2017, nga programi buxhetor “Administrimi i pyjeve” pranë Ministrisë së Mjedisit, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në “Fletoren Zyrtare”, duhet të paraqesin në sekretariatin teknik, pranë Ministrisë së Mjedisit, kalendarin me të gjitha afatet e



parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të projektit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit, përpara fundit të tremujorit të dytë, të vitit 2017. Për fondet e projekteve të paprocuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Mjedisit, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1 Lista e projekteve të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me cikël zbatimi 2017-2018

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU ELBASAN				
1	Bashkia Prrrenjas	Gjelbërimi nëpërmjet pyllëzimeve i kurorës së qytetit Prrrenjas.	12,000,000	12,000,000
QARKU SHKODËR				
2	Bashkia Vau i Dejës	Gjelbërimi i mjedisve publike të Bashkisë ‘Vau i Dejës’	87,000,000	87,000,000
TOTALI			99,000,000	99,000,000

Shënim: 1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit për projektin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor “Administrimi i pyjeve” të Ministrisë së Mjedisit, për vitin 2017.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë